



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 3046/Prot.

Pogradec, më 30.07. 2026

VENDIM

NR. 90, DATË 29.07.2026

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29.06.2026 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 29.06.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 29.06.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.07, 2026

ORA: 12:00

JANË PREZENT 17 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 29.06.2026
, ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 09.06.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 09.06.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Maj 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec (faza1).
7. **Projekt – Vendim:** Ndryshimin e Vendimit nr. 33 datë 30.03.2026 të Tavanëve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.
8. **Projekt – Vendim:** Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit.
9. **Projekt – Vendim:** Për akordimin e ndihmës financiare znj. Aspasia Vako, Lagjia 5, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.
10. **Projekt – Vendim:** Për akordimin e ndihmës financiare znj. Hysnije Sadikaj, Bucimas, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit
11. **Projekt – Vendim:** Përdorimin për nevojat e enteve të Bashkisë të sasisë së materialit drusor të sekuestruar.
12. **Projekt- Vendim:** Për një rishpërndarje në VKB nr 128, datë 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për viti 2026”.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

Znj. Kamolli (Kryetare e Këshillit): Përshëndetje! Jemi mbledhur për zhvillimin e mbledhjes së radhës. Materialet ju janë vënë në dispozicion si në mënyrë elektronike, ashtu edhe në formë shkresore. Ju lutem, të bëhet prezenca.

Znj. Bojko: Prezente janë 17 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me rendin e ditës.

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

Znj. Kamolli: Atëherë, e hedhim në votim rendin e ditës. Kush është dakord, ju lutem?

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhja e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

2. Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 09.06.2026.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Kush është dakord, e hedhim në votim.

U votua

Pro 18

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Znj. Kamolli: Ju lutem, nëse dikush ka konflikt interesi, le ta deklarojë.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 09.06.2026.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të dit. Lexohet vendimi i Prefekturës.

5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Maj 2026.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës. Fjalën e merr znj. Luljeta Mancellari.

Znj. Mancellari : Për muajin maj 2026 janë trajtuar gjithsej 95 familje, me një fond në vlerën 372,011 lekë. Krahësuar me muajin e kaluar, gjatë këtij muaji janë trajtuar më pak familje.

Znj. Kamolli: Në rregull. Nëse nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë për miratim me votim. Ju lutem, kush është dakord?

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

6. Projekt – Vendim: Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec (fazal).

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës. Ju lutem.

Znj.Karapanca : Përshëndetje. Pika që paraqitet sot ka të bëjë me fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Së bashku me PBA-në janë paraqitur edhe tavanet buxhetore. Në fakt, procedura do të duhej të ishte që fillimisht të miratoheshin tavanet buxhetore dhe më pas Programi Buxhetor Afatmesëm, por për shkak të një ndryshimi të vogël, po i paraqesim të dyja paralelisht, pasi janë të ndërlidhura.

Sa i përket tavaneve buxhetore, është bërë vetëm një ndryshim i vogël në çeljen e fondeve në sistem. Duke qenë se në fillim të vitit transfertat miratohen në lekë dhe në sistem regjistrohen me tre shifrat e fundit të sakta, është bërë një korrigjim i vogël në disa programe, i cili lidhet vetëm me këto tre shifrat e fundit, në mënyrë që të ketë përputhshmëri të plotë me sistemin.

Ndërkohë, Programi Buxhetor Afatmesëm është në fazën e parë të hartimit. Të gjitha vërejtjet dhe propozimet do të merren në konsideratë dhe do të pasqyrohen në fazën e dytë të programit.

Znj. Kamolli: A dëshiron të marrë fjalën ndonjë anëtar i komisionit?

Znj. Shuli: Po, kjo çështje është diskutuar edhe në komision. Mendoj se relacioni shpjegues ka një rëndësi të veçantë dhe është edhe më i rëndësishëm se diskutimi që po zhvillohet sot, pasi ai paraqet në mënyrë të detajuar argumentimin dhe bazën e këtij programi.

Znj. Kamolli: E hedhim në votim, ju lutem.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

7. **Projekt – Vendim:** Ndryshimin e Vendimit nr. 33 datë 30.03.2026 të Tavanëve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës. Kush është dakord, e hedhim në votim, ju lutem.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



8. **Projekt – Vendim:** Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

Z. Dulellari: Përshëndetje. Kjo procedurë është ndërmarrë për shkak të një problematike që ka mbetur pezull ndër vite. Mbledhja me komisionet u zhvillua ditën e premte, sipas kërkesës së drejtë që pati z. Ahmet. Të gjitha sqarimet janë dhënë në relacion. Edhe pse janë hequr tre emra nga baza ligjore, bëhet fjalë për një ngërç formal që ka mbetur prej vitesh. Me miratimin e këtij projektvendimi do të zhblllokohen shumë familje.

Znj. Kamolli: Unë u mora personalisht me këtë çështje. Ideja ishte që të sqarohej më mirë baza ligjore.

Znj. Enjela: Po flas si qytetare. Pas vdekjes së nënës sime shkova të merrja certifikatën e pronës, të cilën e kishim marrë para disa vitesh. Duhej të bëhej çelja e trashëgimisë. Dorëzova certifikatën që kishim dhe kërkova që ajo të lëshohej në emrin tim dhe të motrës, por mora përgjigje se mungonte vula e noterit, e cila kishte dalë në vitin 1994, ndërkohë që dokumenti ynë ishte më i hershëm. Prandaj desha të jap një sqarim më të saktë. Si rasti im ka shumë të tjerë. Edhe Bashkia e kishte aplikuar më parë këtë procedurë, por për një arsye u ndërpre. Tani po risillen edhe një herë këto raste.

Znj. Topa: Procesi i privatizimit ka filluar në vitin 1994 dhe ka përfunduar në vitin 2007. Ky është një ngërç që është tërësisht përgjegjësi e administratës. Qytetarëve u takon ky shërbim. Sa i përket projektvendimit, ai është i plotë dhe baza ligjore është e plotë. Mendoj se nuk ka asgjë të pasqaruar në këtë proces.

Znj. Shuli: Në komisione u diskutua gjatë për këtë projektvendim, sepse është absurde që të legalizohen objekte pa leje, ndërsa për objektet e ligjshme të ketë pengesa të tilla. Për mua ky është një ngërç institucional që duhet të marrë zgjidhje njëherë e mirë, në mënyrë që qytetarët të pajisen me certifikatat e pronësisë që u takojnë.

Z. Dulellari: Mendoj se pas këtij vendimi do të paraqiten edhe shumë familje të tjera.

Znj. Kamolli: Dosjet ju i keni.

Znj. Topa: Ju është dhënë një rekomandim, pasi për disa raste mungonte vula. Kjo është një procedurë administrative.



Z. Male: Për këtë rast do të thoja se duhet të ndihmohen sa më shumë raste të kësaj natyre. Të gjithë e dimë sa pasoja sjell mungesa e një certificate pronësie. Sa më shumë raste të trajtohen, aq më mirë.

Z. Dulellari: Ne e bëjmë këtë për të ndihmuar qytetarët.

Znj. Gusho : Përsëritet. Kam punuar për shumë vite në arkiv dhe na vinin vazhdimisht kërkesa të këtij karakteri nga qytetarët. Kishim problematika për shkak të mungesave në dokumentacion, por nuk duhet të harrojmë edhe dëmtimin e dokumenteve gjatë vitit 1997. Po flas nga këndvështrimi i arkivit. Këto dokumentacione nuk përfshiheshin në ruajtjen arkivore, por tani po bëjmë diçka shumë të domosdoshme, që qytetarët, të cilët kanë pritur për 30 vite, më në fund të marrin zgjidhje.

Znj. Elezaj : Po për kërkesat që ka bërë kryetari i fshatit?

Z. Dulellari: Kjo nuk është pjesë e rendit të ditës, por mund t'ju shpjegoj. Kur flasim për prona private, Bashkia ka vetëm rol ndërmjetësues. Në momentin që palët nuk arrijnë dakordësi, i drejtohen institucioneve ligjzbatuese.

Znj. Kamolli: Këto janë banesa që janë privatizuar, ndërsa ato të tjerat janë banesa që janë pronë e Bashkisë.

Z. Babasuli: Çështja trajtohet deri në fazën kur arrihet mirëkuptimi. Nëse nuk arrihet mirëkuptim, ndiqen procedurat përkatëse.

Znj. Kamolli: Kolegë, ju lutem, për këto pyetje në përfundim të mbledhjes mund t'ju japë një sqarim. Nëse jemi dakord, e hedhim në votim.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



9. **Projekt – Vendim:** Për akordimin e ndihmës financiare znj. Aspasia Vako, Lagjia 5, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

Znj. Ziko: Kemi sjellë dy raste për të njëjtën arsye. Njëri është rasti i Aspasia Vako dhe tjetri i Hysnie Sadikaj. Në të dyja rastet bëhet fjalë për dëme në orenditë shtëpiake. Rasti i Buçimasit është një rast më i rëndë.

Znj. Kamolli: Janë procedura, ashtu siç i kemi ndjekur edhe herë të tjera. E rëndësishme është që dokumentacioni është i plotë. E hedhim në votim, ju lutem.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

10. Projekt – Vendim: Për akordimin e ndihmës financiare znj. Hysnije Sadikaj, Bucimas, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës. E hedhim në votim, ju lutem.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

11. Projekt – Vendim: Përdorimin për nevojat e enteve të Bashkisë të sasisë së materialit drusor të sekuestruar.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës.

Z. Arben Braho: Të gjitha lëndët drusore që konstatohen pa leje bëhen pronë e Bashkisë dhe janë në administrimin e saj. Ashtu siç kemi ndjekur procedurat edhe vitin e kaluar, kjo sasi drusore shpërndahet nëpër shkolla.

Z. Male: Kjo sasi drusore është për një vit?

Z. Braho : Po.

Z. Male: Ajo që doja të thoja është se prerja e paligjshme e pyjeve vazhdon të jetë një problem shumë i madh, sidomos në zonën e Mokrës. Ne e kemi ngritur këtë problematikë shumë herë. Nuk e di çfarë masash janë marrë nga Bashkia. Në fillim të vitit miratua një projektvendim për blerjen e një droni, i cili nuk kushtonte pak, dhe nuk e di nëse është vënë në funksion për parandalimin e paligjshmërisë. Para pak muajsh, në zonën e Slabinjës, pati një katastrofë në pyje. Nuk e di pse nuk merren masa. Nuk kam diçka personale me ju, por dua të di se çfarë masash po merren dhe cilat janë masat e shtuara nga Bashkia.


Z. Braho: Droni nuk është marrë ende, por janë kryer kontrolle dhe janë marrë masa edhe për rastin e Slabinjës.

Z. Male: Çfarë masash janë marrë?

Z. Braho: Kemi edhe zona të tjera problematike. Grupet e inspektimit janë vazhdimisht në terren.

Z. Male: Unë shoh që nuk ka ndryshuar asgjë. Duhet të bëjmë të pamundurën për parandalimin e prerjeve të paligjshme.

Z. Markel: Gjatë viteve 2025–2026 janë marrë 18 masa me gjoba administrative ndaj personave të konstatuar nga Drejtoria e Pyjeve. Në disa raste kemi pasur edhe bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Një nga masat e marra ka qenë gjoba në vlerën 3 milionë lekë, ndërsa në rastet e përsëritjes së shkeljes gjoba është dyfishuar. Të gjitha procedurat janë dërguar në gjykatë. Inspektorët i kanë zonat të ndara dhe janë vazhdimisht në terren. Gjatë viteve 2025–2026 janë konstatuar masa administrative si për prerjet e paligjshme, ashtu edhe për transportin e paligjshëm të lëndës drusore.



Z. Male: Ajo që më shqetëson është se kemi rritur edhe numrin e punonjësve. Vitin e fundit është shtuar numri i punonjësve në drejtorinë tuaj, si edhe fondet për këtë drejtim, por përsëri nuk po arrijmë ta eliminojmë këtë fenomen, ndërkohë që Bashkia i ka të gjitha mekanizmat e nevojshëm.

Znj. Kamolli: Atëherë, e hedhim në votim pikën 11. Kush është dakord?

U votua

Pro 18

Kundër 0

Abstenim 1 (Arbër Male)

Miratohet Po Jo



12. Projekt- Vendim: Për një rishpërndarje në VKB nr 128, datë 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për viti 2026”.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

Znj. Irsa: Duhet të bëjmë rishpërndarjen e fondeve që të kalojnë nga Bashkia te Ndërmarrja e Punëve Publike për blerjen e një makine. Shuma prej 2 milionë lekësh është në dispozicion, ndërsa makina është vlerësuar në 5 milionë lekë të reja. Diferenca prej 3 milionë lekësh do të mbulohet përmes rishpërndarjes së fondeve nga Bashkia.

Znj. Zhaneta: Kam një ankesë. Nuk respektohen fare vijat e bardha dhe nuk merren masa. Nuk vendosen as gjopa nga policia. Sa i përket blerjes së makinës jam dakord, pasi duhet për vijëzimin, duhen statistikat, por duhet të kërkohet edhe llogari që rregullat të respektohen.

Z. Male: Kemi hyrë në sezonin turistik dhe Bashkia ende nuk i ka përfunduar vijëzimet.

Z. Gorica: Sinjalistika dhe tabelat janë plotësuar në të gjitha rrugët e qytetit, ndërsa vijëzimi i rrugëve është kryer me dorë.

Z. Male: Ju nuk mbani asnjë lloj përgjegjësie, as për cilësinë dhe as për sasinë e punimeve.

Znj. Biba: Duhet të na sqaroni se çfarë makine është.

Znj. Kamolli: E hedhim në votim, ju lutem.

U votua

Pro 17

Kundër 1 (Arbër Male)

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.06.2026

Znj. Kamolli: Pika të tjera nuk ka. Nëse keni ndonjë pyetje, jeni të lirë të diskutojmë.

Z. Male: Kam bërë një shkresë dhe jam në pritje të përgjigjes. Pika tjetër që dua të diskutoj është çështja e banorëve të Lumit të Verdhovës.

Znj. Kanina: Shkresa është gati. Sa i përket banorëve të Lumit të Verdhovës, kemi vendosur të zhvillojmë një takim.

Znj. Kamolli: Ju faleminderit. E deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Sekretar e Këshillit

Jona Bajko

JuB